

ANALIZË E NDËRMJETËSIMIT TË LEKSIKUT NË METODËN *STUDIO D* TË SHTËPISË BOTUESE CORNELSEN

Alida EMINI-ISMAILI

Universiteti i Tetovës, Fakulteti i Filologjisë, Gjuhë dhe Letërsi Gjermane

alida.emini@unite.edu.mk

UDC 811.112.2'243:37.091.3

Conference paper

Abstract

The aim of this paper is to mediate the German language lexicon in the Studio D method of the Cornelsen publishing house (Authors: Funk, Hermann, Demme, Silke, Kuhn, Christina, Bayerlein, Oliver). The efficiency of achieving the goals and the learning objectives in mediating the lexicon during the language practice in the subject *Contemporary German Language* (semester 1-8) by the method D is the essential purpose of this paper. The lexicon can be presented to students in various books/methods. On one hand, the language is integrated into texts, supported by photographs and is linked to different language skills, while on the other hand the text can be presented without pictures and can be practiced in multiple ways or methods.

The forms and the contents of the exercises will be elaborated in this paper. The Studio D method is divided into four volumes, each volume being appropriate for the respective language level. Starting from the lowest or beginner level A1, which gradually changes its content to other higher levels A2, B1 and B2. In transparent teaching sequences, the Studio D method offers lexical exercises for each level separately, in accordance with different skills, such as: understanding through reading and listening, the versatility of oral expression, conversation and speech creativity as well as the versatility of expression by writing.

Key words: *Semanticization of words, word formation, work with dictionaries.*

Përmbledhje

Qëllimi i këtij punimi është ndërmjetësimi i leksikut të gjuhës gjermane në metodën *Studio d*, të shtëpisë botuese Cornelsen (Autorët: Funk, Hermann; Demme, Silke; Kuhn, Christina; Bayerlein, Oliver). Efikasiteti i arritjes së qëllimeve dhe objektivave mësimore në

ndërmjetësimin e leksikut gjatë praktikës gjuhësore në lëndën Gjuha e sotme gjermane (semestri 1-8) me anë të metodës *Studio d* është qëllimi thelbësor i këtij punimi.

Leksiku mund t'iu prezantohet studentëve në libra/metoda të ndryshme. Nga njëra anë integrohet leksiku në tekste, përkrahet me anë të fotografive dhe lidhet me shkathtësi gjuhësore të ndryshme, ndërsa nga ana tjetër teksti mundet të prezantohet pa fotografi dhe mundet të ushtrohet në variante të shumta. Format dhe përmbajtjet e ushtrimeve do të shtjellohen në këtë punim. Metoda *Studio d* ndahet në katër vëllime, secili vëllim është i përshtatshëm për nivelin përkatës gjuhësor.

Duke filluar nga niveli më i ulët apo fillestar A1, dhe gradualisht ndryshon në përmbajtjen e sajë për nivelet tjera më të larta A2, B1 dhe B2. Në sekuenca transparente mësimore metoda *Studio d* ofron për secilin nivel veçmas ushtrime leksikore për shkathtësi të ndryshme siç janë: kuptimi me anë të leximit dhe dëgjimit, shkathtësia e të shprehurit me gojë, gjegjësisht bashkëbisedimi dhe krijimtaria e folur, si dhe shkathtësia e të shprehurit me shkrim.

Fjalët kyçe: *Semantizimi i fjalëve, fjalëformimi, puna me fjalorë.*

Hyrje

Ndërmjetësimi i leksikut në mësimdhënien e gjuhëve të huaja kryesisht realizohet në formën eksplicite të prezantimit të leksikut që favorizon ruajtjen e fjalëve të reja në leksikun mendor. Sipas autorit Günther Storch mundemi t'u qasemi njësive leksikore përmes kanaleve të ndryshme, këtu me rëndësi të veçantë dallohen dy forma: e para, e cila ka të bëjë me atë se çka mund të bëhet me fjalët/leksemat, dhe e dyta, e cila ka të bëjë me atë se si dhe në sa mënyra mund të ushtrohen apo të vehen në përdorim fjalët apo leksemat.¹

Fjalët e reja duhet të prezantohen dhe të ushtrohen sipas kontekstit dhe situatës. Ajo që duhet arritur është një asocim solid mes formës së leksemës dhe përmbajtjes së sajë. Konteksti gjuhësor, prezantimi dhe ushtrimi duke iu referuar situatës, ndihma e mjeteve pamore (fotot e risin aftësinë e të mbajturit mend), objektet, veprimet aktive të atyre që mësojnë e përforcojnë leksikun në memorien njerëzore.²

¹ Storch, Günther (1999): *Deutsch als Fremdsprache: eine Didaktik: theoretische Grundlagen und praktische Unterrichtsgestaltung*, München: Wilhelm Fink, fq. 56-57.

² Po aty, fq. 57.

Të nxënurit përmes	E mbajtur mend	E harruar
dëgjimit	20%	80%
të pamurit	30%	70%
dëgjimit dhe të pamurit	50%	50%
të folurit	70%	30%
dëgjimit, të pamurit dhe veprimit	90%	10%

Të nxënurit përmes kanaleve të ndryshme.³

1. Format e ushtrimeve leksikore në metodën *Studio d*

Metoda *Studio d*⁴ ndahet në katër vëllime, secili vëllim është i përshtatshëm për nivelin përkatës gjuhësor. Duke filluar nga niveli më i ulët apo fillestar A1, dhe gradualisht ndryshon në përmbajtjen e sajë për nivelet tjera më të larta A2, B1 dhe B2. Në sekuenca transparente mësimore metoda *Studio d* ofron për secilin nivel veçmas ushtrime leksikore për shkathtësitë e ndryshme siç janë: kuptimi me anë të leximit dhe dëgjimit, shkathtësia e të shprehurit me gojë, gjegjësisht bashkëbisedim dhe krijimtari e folur, si dhe shkathtësia e të shprehurit me shkrim. Në librin *Studio d* është i integruar edhe libri i punës, në të cilën përfshihen vetëm ushtrime, detyra, kuize, etj., për të gjitha shkathtësitë gjuhësore.

Në metodën *Studio D* struktura e prezantimit të leksikut mund të ndahet përafërsisht në këtë mënyrë:

- Tekste – tekste leximi apo tekste dëgjimi.
- Fotografji – vizatime, ilustrime etj.
- Glosar – listë me fjalë.
- Ushtrimet leksikore për foljet: disa folje që shkaktojnë vështirësi në të kuptuarit e funksionit të tyre, foljet që rrjedhin nga mbiemrat.

³ Po aty, fq. 56.

⁴ Funk, Hermann; Kuhn, Christina; Demme, Silke (2010): *Studio D A1.u. B1. Deutsch als Fremdsprache-Kurs- und Übungsbuch*. Cornelsen Verlag, Berlin.

Kuhn, Christina; Niemann, Rita; Winzer-Kiontke, Britta (2010): *Studio D B2/1. Deutsch als Fremdsprache-Kurs- und Übungsbuch*. Cornelsen Verlag, Berlin.

Kuhn, Christina; Winzer-Kiontke, Britta; Würz, Ulrike (2011): *Studio D B2/2. Deutsch als Fremdsprache-Kurs- und Übungsbuch*. Cornelsen Verlag, Berlin.

- Ushtrime leksikore për emrat: emërtimi i personave, domethënia e disa emrave, forma e shumësit dhe problemet që paraqiten gjatë përvetësimit të shumësit të emrave, ushtrime mbi huazimet.
- Ushtrime me udhëzime për mënyrat e fjalëformimit.
- Ushtrime për punën me fjalorë.

Leksiku prezantohet në tekste duke u mbështetur me fotografi të ndryshme që përputhen me tekstin. Gjatë ndërmjetësimit të leksikut me tekstet nga metoda *Studio d* jepen disa fjalë të reja dhe me ndihmën e ushtrimeve sqarohet kuptimi i këtyre fjalëve të reja. Mënyra e sqarimit të kuptimit të fjalëve të reja, gjegjësisht semantizimit të tyre në metodën *Studio d* janë të ndryshme, ndër më të rëndësishmet janë këto si vijojnë:

- Me anë të një asociogrami.
- Me anë të një liste fjalësh nga tema të ndryshme të njësive mësimore.
- Me anë të sqarimit njëgjuhësor (vetëm në gjermanisht) të fjalëve.
- Me anë të një bisede hyrëse të shkurtër.

2. Përmbajta dhe qëllimet e ushtrimeve leksikore në metodën *Studio d*

Duke filluar nga niveli A1 metoda *Studio d* është e strukturuar në atë mënyrë që starti për fillestarët e gjuhës të jetë tejet motivues dhe i qartë dhe ushtrimet leksikore janë të formuluar në atë mënyrë, që hap pas hapi mundësohet të fitohen njohuritë e duhura, shumë lehtë arrihet përvetësimi i leksikut të gjuhës gjermane, duke i zgjedhur detyrat dhe ushtrimet leksikore, si dhe me përsëritjen e njohurive të përfituara të cilat e përforcojnë leksikun e mësuar.

Secili vëllim i *Studio d* ka nga 8 deri në 12 njësi mësimore dhe mund të përpunohet në 120-150 orë mësimore. Kjo metodë i plotëson të gjitha kërkesat e një metode moderne, edhe atë:

- Zbatimin transparent të qëllimeve mësimore që orientohen sipas standardeve të portfolios evropiane për gjuhë të huaja;
- Integrimin e skenarëve profesionale dhe prezantimin e fotografive të profesioneve;
- Shumë detyra për automatizmin e frazave të sakta dhe për të shprehurit të rrejdshëm verbal;
- Trajnimin gjuhësor konsekuent që nga fillimi.⁵

⁵ Shih: <http://www.cornelsen.de/home/reihe/r-4530/ra-8115/konzept> (05.12.2018).

Metoda *Studio d* përmban edhe glosar apo listë me fjalë, e cila gjatë orës mësimore shumë pak gjen përdorim. Studentët shërbejnë me këtë listë apo glosar më shumë në shtëpi gjatë përgatitjes së tyre për detyrat e shtëpisë apo përsëritjes së njësive mësimore.

- Fjalëformimi dhe mënyrat e fjalëformimit paraqesin një ushtrim leksikor tejet të rëndësishëm në *Studio d*, natyrisht duke u bazuar në aspektet kryesore gjuhësore. Rregullat mbi fjalëformimin janë shumë të rëndësishme për të kuptuar domethënien e fjalëve. Mësimdhënësi duhet patur kujdes gjatë sqarimit të rregullave, pasi ekzistojnë kthime, gjegjësisht ndryshime të shumta të fjalëve, që shpesh shprien në gabime gjatë formulimit të fjalëformimeve. Këtu jepen të dhëna konkrete për komponentët gramatikore: ndryshimet e fjalëve, elementet shitesë; për komponentët semantike: kuptimet bazë, ndryshimet në kuptime; për komponentët në kontekst: udhëzime situative të kuptimit.⁶
- Puna me fjalorë (*Arbeit mit Wörterbüchern*) paraqet një aspekt të rëndësishëm në përvetësimin e leksikut, ngase fjalorët njëgjuhësor dhe dygjuhësor shërbejnë si mjete ndihmëse për gjatjen e kuptimit të fjalëve. Metoda *Studio d* jep udhëzime të qarta për punën me fjalorë.
- „*Puna me fjalorë shprien në pavarësi, mirëpo duhet konsideruar se duhet të ndërmejtësohen edhe teknikat për përdorimin e fjalorit*“.⁷

2.1. Metoda *Studio d*, niveli A1

Në nivelin A1 mësohen internacionalizmat që përdoren edhe në gjuhën gjermane, format e përshëndetjes, apo prezantimi i vetvetes dhe familjes, dhe njëkohësisht mësohet formulimi i pyetjeve lidhur me këto tema. Në nivelin fillestar A1 gjithashtu përvetësohen numrat, gjegjësisht emërohen dhe kuptohen numra përkatëse të adresave, të telefonit, të çmimeve etj. Në metodën *Studio d* të nivelit A1 leksiku është i pasuruar me forma të ushtrimeve që kanë të bëjnë me një përmbajtje të pasur për përshkrimin e ngjarjeve të ditës, përshkrimin e profesioneve të ndryshme, vendeve të punës, si dhe përshkrimin e një vendi apo orientimin për të arritur në një pikë të caktuar.

⁶ Shih: http://www.cornelsen.de/studio_d/1.c.2597753.de (05.12.2018).

⁷ Bohn, R. (2005): “*Arbeit mit Wörterbüchern führt zur Selbstständigkeit, man muss aber bedenken, dass auch Techniken zur Benutzung von Wörterbüchern vermittelt werden müssen*”: Wortschatzarbeit und Wortschatzvermittlung, Studienreihe DaF, fq. 19

2.2. Metoda *Studio d*, niveli A2

Në nivelin A2 metoda *Studio d* ofron leksikun pak më të pasuruar nga ai fillestar të nivelit A1. Ushtrimet janë të përpiluara në forma të ndryshme të kategorive leksikore, duke u koncentruar në përvetësimin e teknikës të të nxënurit të fjalëve me kuptim të kundërt apo të njëjtë (sinonimet / antonimet). Gjithashtu përvetësohet kategorizimi i leksikut, fushat e fjalëve (*Wortfelder*) si dhe të përvetësohet bashkimi apo kombinimi i emrave dhe foljeve (*Feste Nomen-Verb-Verbindungen*), që në gjuhën gjermane paraqesin një ndër format leksikore më të ndërlikuara.

2.3. Metoda *Studio d*, niveli B1

Në nivelin B1 metoda *Studio d* përmban njësi mësimore me një progresion tematik dhe gramatikorë. Mënyra e prezantimit dhe radhëtes së ushtrimeve leksikore në metodën *Studio d B1* kanë për qëllim të nxisë të mësuarit hulumtues te studentët si dhe t'u ndihmojë atyre të njohin, kuptojnë dhe përdorin veprime gjuhësore me një leksik më të pasur që korrespondon me nevojat e tyre për komunikim të rrjedhshëm në gjuhën gjermane në sfera të ndryshme të jetës, por me një fokus të veçantë në fushën profesionale.

Kryesisht ushtrimet japin të dhëna për profesione të ndryshme që ushtrohen në Gjermani dhe vendet gjermanishtfolëse. Në këto ushtrime kërkohet nga ana e studentëve të tërhiqen paralele me profesionet në vendlindjen e tyre. Gjuha e komunikimit në punë dhe jashtë punës është gjithashtu një temë ku bëhen ndërmjetësime të termeve, shprehjeve dhe frazave tipike që janë të njohura në gjuhën gjermane.

2.4. Metoda *Studio d*, niveli B2

Në nivelin gjuhësor B2 metoda *Studio d* përmban ushtrime leksikore më të ndërlikuara, më të pasura në përmbajtje ku me anë të ushtrimeve në shkathtësinë Kuptimi (dëgjimi dhe leximi), studentët mund të ushtrojnë tekste të gjata, të lexojnë artikuj në lidhje me problemet bashkëkohore si dhe të ushtrojnë vokabularin përmes letërsisë bashkëkohore gjermane. Ushtrimet leksikore të këtij niveli ofrojnë një fjalor më të pasur letrar. Në shkathtësinë e të shprehurit me shkrim dhe me gojë (bashkëbisedimi dhe krijimtaria e folur) janë të përpiluara forma të ushtrimeve ku studentëve u mundësohet të ushtrojnë komunikim të rrjedhshëm në gjuhën gjermane.

Për shkathtësinë e të shprehurit me shkrim janë përpiluar forma të ushtrimeve, ku studentët duhet të shprehin aftësitë e tyre për formulimin e fjalive të sakta, duke përdorur kombinime të ndryshme të leksikut të gjuhës gjermane. Veçanërisht duhet cekur se në

metodën *Studio d B2* studentëve u ofrohen ushtrime me një spektër të gjerë që kanë një përmbajtje të synuar për përdorimin e saktë të fjalorit njëgjuhësorë, për përdorimin apo punën me fjalorë dhe leksikon, të bëhet njohja apo gjetja e fjalëve nga konteksti, me anë të fotografive të bëjnë ndërtimin apo formulimin e hipotezave.

Gjithashtu ushtrimet e *Studio d B2* kërkojnë që studentët, fjalët e bashkërenditura t'i fusin apo integrojnë në një tekst si dhe të ndërtojnë dialogje duke përdorur fraza të ndryshme. Krahas metodës *Studio d* shtypi Cornelsen për studentët ofron CD ku në formë elektronike mund të instalohet e tërë metoda si dhe ushtrimet e ndryshme gjuhësore mund të realizohen në formë elektronike dhe automatikisht mund të korrigjohen. Gjithashtu në formë elektronike gjendet glosari, që u mundëson studentëve shumë lehtë ta përvetësojnë leksikon e gjuhës gjermane.

Ushtrimet për ndërmjetësimin e leksikut paraqesin teknikat dhe metodat për sqarimin e kuptimit të fjalëve. Duke u koncentruar në pyetjet se çka duhet të dijë studenti për kulturën gjermane dhe termet e ndryshme të gjuhës gjermane, kështu ofrohen metoda dhe teknika për sqarimin e kuptimit, si dhe përforcimin e fjalëve të gjuhës gjermane. Duke u bazuar në temat e përcaktuara për secilin nivel, ashtu janë të ndara edhe detyrat dhe leksiku i tyre. Nga studentët kërkohet që të mund të përvetësojnë përdorimin e fjalorit njëgjuhësor dhe dygjuhësor. Secili term i ri sqarohet në fusha të ndryshme gramatikore, si p.sh. fonetike, morfologjike, sintaksore etj.

Kjo e bën metodën *Studio d* edhe më efikase ngase për leksikon e dhënë jep informata të caktuara që e pasurojnë studentin me njohuri të nevojshme në lidhje me një term apo fjalë të caktuar. Ushtrimet për ndërmjetësimin e leksikut dhe për përvetësimin efikas të tij në metodën *Studio d* japin sqarime për leksemat në veçanti sipas këtyre kategorive:

- **Forma:** *Studenti duhet të njoh një fjalë si të tillë në formë të shkruar dhe të shqiptuar në kontekste të ndryshme.*
- **Gramatikë:** *Studenti duhet të dijë në cilat kategori gramatikore mund të përdoret fjala.*
- **Lidhja:** *Studenti duhet të dijë si mund të përdoret fjala në formën sintaksore.*
- **Funksioni:** *Studenti duhet të dijë se si mund ta përdorë dhe ta kuptojë fjalën në kontekste të ndryshme.*
- **Shqiptimi:** *Studenti duhet ta artikulojë fjalën qartë.*
- **Kuptimi:** *Studenti duhet të njohë kuptimin e fjalës, do të thotë duhet të ekzistojë një lidhje kognitive mes formës së fjalës dhe një koncepti apo fotografie.*
- **Relacioni:** *Studenti duhet të jetë i vetëdijshëm për lidhjet semantike të fjalës .*

- **Fjalëformimi:** *Studenti duhet të dijë si formohet një fjalë dhe si mund të përdoret në përputhje me rrethanat.*⁸

Studenti duhet ta përdorë fjalën në formë aktive, do të thotë fjala duhet të ekzistoj në memorien leksikore të tij dhe të mundet të “thirret/kërkohet” nga kujtesa. Ky përshkrim e bën të qartë se një student mundet të kuptojë domethënien e një fjale vetëm atëherë kur i ka të përvetësuar njohurit mbi formën, gramatikën, lidhjen, funksionin, shqiptimin, kuptimin, relacionin dhe fjalëformimin e sajë.

Përfundimi

Nga përvoja e punës me metodën *Studio d* mund të konstatoj se, për sa i përket ndërmjetësimit të leksikut, mësimdhënësit në mënyrë transparente dhe interaktive i jepet mundësia që me shumë lehtësi dhe efikasitet të planifikojë orën mësimore. Ustrimet janë të larmishme dhe mjetet mësimore si CD dhe video incizimet, kartelat, glosarët, vizatimet dhe hartat e ndryshme që i ofron metoda *Studio d* për ndërmjetësimin e leksikut, si dhe ustrimet për përdorimin e fjalorit, e bëjnë orën mësimore të gjuhës gjermane si gjuhë të huaj shumë motivuese dhe efektive. Synimet dhe objektivat arrihen me sukses, që do të thotë se ato jo vetëm që i japin një kualitet orës mësimore, por e bëjnë atë tejet interesante për studentët dhe njëkohësisht e pasurojnë thesarin e tyre leksikor.

Bibliografia

- Bohn, R. (2005): Wortschatzarbeit und Wortschatzvermittlung, Studienreihe DaF.
- Funk, Hermann / Kuhn, Christina / Demme, Silke (2010): studio d A1.u. B1 Deutsch als Fremdsprache-Kurs-und Übungsbuch. Cornelsen Verlag, Berlin.
- Kuhn, Christina / Niemann, Rita / Winzer-Kiontke, Britta (2010): studio d B2/1. Deutsch als Fremdsprache-Kurs-und Übungsbuch. Cornelsen Verlag, Berlin.
- Kuhn, Christina/ Winzer-Kiontke, Britta / Würz, Ulrike (2011): studio d B2/2. Deutsch als Fremdsprache-Kurs-und Übungsbuch. Cornelsen Verlag, Berlin.
- Storch, Günther (1999): Deutsch als Fremdsprache: eine Didaktik: theoretische Grundlagen undpraktische Unterrichtsgestaltung, München: Wilhelm Fink.

⁸ Bohn, R. (2005): Wortschatzarbeit und Wortschatzvermittlung, Studienreihe DaF, fq. 35.